

Urdhër nr. 102, datë 21.2.2020 “Për procedurat standarde të veprimit (psv) për punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, për zvogëlimin e rrezikut të përjetimit të dhunës në familje e të dhunës me bazë gjinore, në situata të emergjencave civile”

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të) për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore, në situata të emergjencave civile, përshkruajnë tërësinë e veprimeve dhe të hapave thelbësorë që duhet të planifikohen, monitorohen, koordinohen, zbatohen dhe vlerësohen rregullisht, në mënyrë korrekte dhe logjike prej tyre, për të parandaluar, si dhe për të ofruar kujdesin dhe ndihmën e duhur për të mbijetuarat/it subjekt i dhunës në familje dhe i dhunës me bazë gjinore (DHF/DHBGJ), si dhe për të zvogëluar rrezikun e përjetimit të DHF-së/DHBGJ-së, gjatë përballimit të situatave të ndryshme të emergjencave civile në Shqipëri, nga gatishmëria deri në rimëkëmbje.

Në dokument parashikohen parimet dhe standardet e ofrimit të shërbimeve për të mbijetuarat subjekt i dhf-së/dhbgj-së, në paragrafin mbi qasjen me ndjeshmëri gjinore përcaktohet se shërbimet shëndetësore duhet të marrin parasysh nevojat e grupeve të veçanta të grave, të rejave dhe të vajzave, duke përfshirë ato që u përkasin grupeve të pafavorizuara (si: rome, egjiptiane, komuniteti LGBTI, **PAK etj.**).

Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet të respektojnë shumëllojshmërinë e përdorueseve dhe përdoruesve të shërbimeve dhe të zbatojnë një qasje jodiskriminuese. Kjo nënkupton që të gjitha gratë, të rejtat dhe vajzat e mbijetuara duhet të kenë qasje të barabartë dhe të plotë në shërbimet shëndetësore, njëllonj si të gjithë burrat, të rinjtë dhe djemtë.

Shërbimet shëndetësore duhet të ofrohen me të njëjtin nivel cilësie për të gjithë njerëzit që kanë nevojë për to, pavarësisht gjinisë, moshës, vendbanimit, përkatësisë fetare, përkatësisë etnike, **aftësive të kufizuara** apo orientimit seksual ndryshe.

Në lidhje me parimin e mosdiskriminimit, dokumenti përcakton se të gjitha/gjithë të mbijetuarat/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të kenë të njëjtat të drejta për përfitimin e shërbimeve shëndetësore, pavarësisht moshës, vendbanimit, racës, kombësisë, besimit fetar, përkatësisë etnike, orientimit seksual, identitetit gjinor, **aftësisë së kufizuar**, statusit martesor, arsimimit dhe statusit socioekonomik të tyre.

Problematika e dhunës me bazë gjinore dhe dhunes ne familje, për vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuar, trajtohet ne disa paragrafe/ kapituj të këtij udhezimi, por do të veçonim adresimin e saj përmes masave të përgjithshme dhe ato specifike për to për parandalimin dhe për reagimin ndaj DHF-së/DHBGJ-së, në situata të emergjencave civile, duke filluar nga hartimi i politikave, programimi i shërbimeve shëndetësore, si dhe informimi mbi këto shërbime përfshirë masa si rritja

e aksesueshmërisë së ambienteve shëndetësore për ofrimin e shërbimeve të integruara të lidhura me DHBGJ-në, duke garantuar vec të tjerash që objektet janë të aksesueshme nga të gjithë personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara; zbatimi i strategjive që rrisin në maksimum cilësinë e shërbimeve në dispozicion për të mbijetuarat/it në objektet shëndetësore, vec te tjerash duke marrë në konsideratë masat e veçanta për të plotësuar nevojat e grupeve të ndryshme në rrezik (fëmijët, LGBTI-të, personat me aftësi të kufizuara etj.); sigurimi që ndarja e informacionit dhe raportimeve të rasteve të DHF-së/DHBGJ-së brenda sektorit të shëndetësisë ose me partnerët në komunitetin më të madh humanitar, bëhet në mënyrë të sigurt dhe sipas standardeve etike dhe duke përdorur formate dhe mjete informuese të përshtatura në gjuhë të shumta (Braille, gjuha e shenjave, mesazhe të thjeshtuara si piktura dhe fotografi etj.), për të siguruar qasje të të gjithë banoreve dhe banorëve të komunitetit.

Për më tepër shiko tekstin e plotë të vendimit: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/02/21/102/4c0f7f2e-5c70-4d84-95df3244559f4c31>